



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

Nr. 4395 prot.

Tiranë, më 14. 05. 2025

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

**SPECIALIST I SEKTORIT TË ADMINISTRIMIT DHE STANDARDIZIMIT TË FONDIT TË
PYETJEVE NË DREJTORINË E PROVIMEVE TË SHTETIT**

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, i ndryshuar dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr. 32, datë 18.02.2025 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Shërbimeve Arsimore”, Qendra e Shërbimeve Arsimore njofton shpalljen e vendit të lirë të punës, në pozicionin: ***Specialistit në Sektorin e Administrimit dhe Standardizimit të Fondit të Pyetjeve në Drejtorinë e Provimeve të Shtetit.***

Përshkrimi i detyrave

- ✓ Administron dhe mirëmban bazën e të dhënave të fondeve të pyetjeve të provimeve të shtetit dhe provimeve të digjitalizuaara
- ✓ Merr në dorëzim dhe digjitalizon programet orientuese dhe fondet e pyetjeve
- ✓ Zbaton procedurat e hartimit, certifikimit dhe rishikimit të fondeve të pyetjeve
- ✓ Ndjek procesin e ankimimit, duke bashkëpunuar me komisionet e provimeve

Kriteret e aplikimit

- ✓ Të ketë përfunduar studimet universitare në fushën e Informatikës (eksperienca e punës përbën avantazh)
- ✓ Të ketë njohuri dhe aftësi shumë të mira, komunikimi në të folur dhe në të shkruar
- ✓ Të ketë njohuri të certifikuara të Gjuhës Angleze (gjuhë të tjera përbëjnë avantazh)
- ✓ Të jetë i aftë për të punuar në grup dhe për të marrë iniciativa
- ✓ Të jetë i aftë në vendosjen e prioritetëve dhe realizimin në kohë të detyrave
- ✓ Të tregojë vullnet për zgjerimin e njohurive profesionale, organizative dhe menaxheriale
- ✓ Të tregojë përkushtim ndaj misionit të institucionit

Dokumentet e nevojshme

- ✓ Letër Motivimi
- ✓ CV (në gjuhën shqipe)
- ✓ Fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave; fotokopje të certifikatave dhe kualifikimeve të tjera
- ✓ Fotokopje e mjetit të identifikimit
- ✓ Vërtetim i gjendjes gjyqësore
- ✓ Raport mjekësor për aftësinë në punë
- ✓ Letër rekomandimi

Paga Paga për pozicionin është në kategorinë IV-2.

Mundësi zhvillimi profesional, trajnime profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kandidati duhet të paraqesë në rrugë postare dokumentacionin e mësipërm, brenda datës **26.05.2025** në adresën:
Qendra e Shërbimeve Arsimore, Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida MYRTO

